



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration



Për :	Ekrem Kastrati, Kryetar i Komunës së Malishevës Argjend Thaçi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 16.05.2022 Nr.-VI-020-741/17
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Ardita Latifi, Zyrtare e lartë për Monitorimin e Komunave	
Lënda:	Shqyrtim i ligshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës	
Lloji i aktit:	Vendim Nr.02/210 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit Nr.02/93 datë: 03.03.2022 për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.02/137 datë:06.05.2016 dhe kontratës Nr.01/782 datë: 25.05.2016	

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në mbështetje të nenit 81.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK)nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, MAPL, me datë 05.05.2022 ka pranuar për vlerësim të ligshmërisë, Vendimin Nr.02/210 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit Nr.02/93 datë: 03.03.2022 për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.02/137 datë:06.05.2016 dhe kontratës Nr.01/782 datë: 25.05.2016.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ka bërë shqyrtimin e ligshmërisë së aktit në fjalë, dhe:

KONFIRMON

Vendimin Nr.02/210 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit Nr.02/93 datë: 03.03.2022 për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.02/137 datë:06.05.2016 dhe kontratës Nr.01/782 datë: 25.05.2016.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.04.2022, ka miratuar Vendimin Nr.02/210 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit Nr.02/93 datë: 03.03.2022 për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.02/137 datë:06.05.2016 dhe kontratës Nr.01/782 datë: 25.05.2016.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Malishevës është bazuar në nenin 11, 12, 17, 40 dhe 58, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 4 të Ligjit Nr.06/L-92 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenin 27 të rregullores (QRK) Nr.09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 53 paragrafi 3, të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe kërkesës për rishqyrtim Nr.020-741/16 datë:21.03.2022 të MAPL-së.

Kryetari i Komunës me datë 27.04.2022, ka marrë vendimin për formimin e komisionit, për shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kontratës nr.01/782, dt.25.05.2016, të lidhur në mes të Komunës së Malishevës dhe Operatorit Ekonomik "PRINC-Company", me seli në Prishtinë, si dhe përgatitjen e raportit me shkrim, të cilin e ka prezantuar para Kuvendit Komunal, duke e bashkëngjitur edhe në Vendimin Nr.02/210 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit Nr.02/93 datë: 03.03.2022 për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.02/137 datë:06.05.2016 dhe kontratës Nr.01/782 datë: 25.05.2016.

Vendimi Nr.02/210 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit Nr.02/93 datë: 03.03.2022 për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.02/137 datë:06.05.2016 dhe kontratës Nr.01/782 datë: 25.05.2016, është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Malishevës me datë 28.04.2022, me 25 vota për (unanimisht).

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za:	Ekrem Kastrati, gradonačelnik opštine Mališevo Argjend Thaçi, predsedavajući Skupštine opštine Mališevo	
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Venera Çerkini, zamenica generalnog sekretara MALS-a	
Od:	Besim Myrtezani, zamenik rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština MALS	Datum: 16.05.2022 Br.-VI-020-741/17
1.Službenik-ca za utvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština	
2.Službenik-ca za izradu pravne procene:	Ardita Latifi, viša službenica za monitorisanje opština	
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Mališevo	
Vrsta akta:	Odluka br.02/210 o dopuni i izmeni Odluke br.02/93 od dana, 3.3.2022. godine, o ukidanju Odluke Skupštine opštine br.02/137 od dana, 6.5.2016. godine, i Ugovora br.01/782 od dana, 25.5.2016. godine, usvojena je na sednici Skupštine opštine Mališevo dana, 28.4.2022, sa 25 glasova "za" (jednoglasno).	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave (MALS) u skladu sa članom 81.4 Zakona br. 03 /L-040 o lokalnoj samoupravi, Uredbom Vlade br. 02/2021 o oblastima i administrativnim odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmenama i dopunama Uredbe VRK br. 10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, MALS je dana 5.5.2022 primio je na ocenjivanje zakonitosti Odluke br.02/210 o dopuni i izmeni Odluke br.02/93 od dana, 3.3.2022. godine, o ukidanju Odluke Skupštine opštine br.02/137 od dana, 6.5.2016. godine, i Ugovora br.01/782 od dana, 25.5.2016. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave (MALS), razmotrio je zakonitost navdenog akta i:

POTVRĐUJE

Odluka br.02/210 o dopuni i izmeni Odluke br.02/93 od dana, 3.3.2022. godine, o ukidanju Odluke Skupštine opštine br.02/137 od dana, 6.5.2016. godine, i Ugovora br.01/782 od dana, 25.5.2016. godine

OBRAZLOŽENJE

Skupština opštine Mališevo na sednici održanoj dana 28.04.2022. godine, usvojila Odluke br.02/210 o dopuni i izmeni Odluke br.02/93 od dana, 3.3.2022. godine, o ukidanju Odluke Skupštine opštine br.02/137 od dana, 6.5.2016. godine, i Ugovora br.01/782 od dana, 25.5.2016. godine.

MALS, konstatuje da donošena odluka od strane Skupštine opštine Mališevo, zasnovana je na članu 11, 12, 17, 40 i 58, Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi, članu 4, Zakona br.06/L-92 o davanju na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine, članu 27, Uredbe VRK br.09/2020, o utvrđivanju postupaka davanja na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine, članu 53, stav 3, Zakona br.05/L-031 o opštem administrativnom postupku, i zahteva za reviziju br.020-741/16 od dana, 21.3.2022. godine, MALS-a.

Gradonačelnik opštine dana, 27.4.2022. godine, doneo je odluku o formiranju komisije za razmatranje i utvrđivanje ugovora br. 01/782, od dana, 25.5.2016. godine, sklopljenog između opštine Mališevo i Ekonomskog operatera "PRINC-Company", sa sedištem u Prištini kao i priprema pismenog izveštaja kojeg je prezentirao pred Skupštinom opštine, priložeći Odluci br.02/210 o dopuni izmeni Odluke br.02/93 od dana, 3.3.2022. godine, za ukidanje odluke Skupštine opštine br.02/137 od dana, 6.5.2016. godine i ugovora br.01/782 od dana, 25.5.2016.

Odluka br.02/210 o dopuni i izmeni Odluke br.02/93 od dana, 3.3.2022. godine, o ukidanju Odluke Skupštine opštine br.02/137 od dana, 6.5.2016. godine, i Ugovora br.01/782 od dana, 25.5.2016. godine, usvojena je na sednici Skupštine opštine Mališevo dana, 28.4.2022, sa 25 glasova "za" (jednoglasno).

Ministarsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.